

NE JEMI PRANË JUSH- JU Jeni Fokus Ynë

Organizata jonë mbështet planifikimin familjar të sigurt dhe vullnetar si një e drejtë e njeriut. Planifikimi familjar është kyç për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave, forcimin e ekonomisë dhe uljen e varfërisë.

Planifikimi familjar parandalon shtatzënitë e pa-planifikuara duke përdorur metoda kontraceptive.



Rëndësia e Planifikimit Familjar

Konferenca Ndërkombëtare për Popullsinë dhe Zhvillimin e vitit 1994 (ICPD), përmes Planit të Veprimit të nënshkruar nga 179 shtete përfshirë dhe shtetin shqiptar, shpalosi një vizion të ri mbi planifikimin familjar.



Ky vizion vë në fokus individin dhe çiftet, të drejtën e tyre për të vendosur sa fëmijë të kenë dhe kur. Kjo ju siguron atyre shëndet të mirë, mirërritjen e fëmijëve dhe mirëqënien e familjes.



UNË VENDOS PËR VETEN



Planifikimi familjar
i sigurt dhe vullnetar
është e drejtë e njeriut.



Bulevardi "Gjergj Fishta", Kompleksi Tirana 2000", Kulla 4. Tiranë
Tel: +355 42 251475, E-mail: info@acpd-al.org; web: http://www.acpd.org.al

Mbështetur nga:




Ky botim jo domosdoshmërisht përfaqëson pikëpamjet dhe qëndrimet e UNFPA-Fondit të Kombeve të Bashkuara për Popullsinë.

Çdo individ duhet t'i garantohet e drejta e planifikimit familjar të sigurt.

Shqipëria ka nivel të ulët të përdorimit të metodave kontraceptive, me vetëm 11% (Studimi Demografik dhe Shëndetësor në Shqipëri, 2008-2009).



Megjithëse metodat moderne kontraceptive ofrohen falas në sistemin tonë shëndetësor, 13% e grave të martuara kanë një nevojë të paplotësuar për planifikim familjar. Këto gra duan të shmangin shtatzëninë, por nuk përdorin metoda efektive të planifikimit familjar për arsye të ndryshme si: pamundësia për të marrë informacion ose shërbime, apo mosmbështetja nga partnerët dhe komuniteti.



*Për më shumë informacion shikoni publikimet në faqen tone të web-it acpd.org.al

Disa metoda Kontraceptive:

Metodat	Çfarë janë?	Mesazhe kyçe
<p>Kontrceptivët oralë të kombinuar</p>	<p>Kontrceptivët oralë janë pilula të cilat përmbajnë doza të ulta të dy hormoneve – progestin dhe estrogen, të ngjashme me hormone natyrale në trupin e grave dhe vajzave.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Mund të përdoren në mënyrë të sigurt dhe të efektshme pothuajse nga të gjitha gratë dhe vajzat. - NUK të mbrojnë nga infeksionet seksualisht të transmetueshme (IST-të), përfshirë edhe HIV.
<p>Prezervativët për meshkuj</p>	<p>Këllëf ose mbështjellëse, të cilat i përshtaten penisit të erektuar të mashkullit. Emërtohen edhe si kondomë, kapote dhe profilaktikë.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Përdorimi i tyre kërkon bashkëpunimin e të dy partnerëve. - Për të rritur efektshmërinë, prezervativët duhet të përdoren në mënyrë korrekte gjatë çdo akti seksual. - E vetmja metodë që ofron MBROJTJE nga shtatzënitë dhe nga infeksionet seksualisht të transmetueshme, përfshirë HIV.
<p>Pilulat kontraceptive të urgjencës</p>	<p>Pilula të cilat përmbajnë vetëm progestin, ose progestin dhe estrogen së bashku, të ngjashme me hormonet natyrale në trupin e grave dhe vajzave.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Ndihmojnë në parandalimin e shtatzënisë, kur merren deri në 5 ditë pas një marrëdhënieje seksuale të pambrojtur. Sa më shpejt të merren, aq më mirë është. - Nuk e ndërpresin shtatzëninë e filluar. - NUK të mbrojnë nga IST-të, përfshirë edhe HIV.
<p>Injeksionet</p>	<p>Janë kontraceptive të injektueshëm një mujour, dy mujour ose tre mujour.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - NUK të mbrojnë nga IST-të. - Gruaja duhet të rikthehet rregullisht në qendrën shëndetësore për injeksionin e radhës.
<p>Dispozitivi intrauterine (DIU)</p>	<p>Është një strukturë e vogël që vendoset në mitër nga një ofrues i kualifikuar i shërbimit shëndetësor.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - NUK të mbron nga IST-të, përfshirë edhe HIV. - Ofron mbrojtje afatgjatë ndaj një shtatzënie të paplanifikuar.